



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) – Rruga Migjeni (ish Banka e Ljublanës), Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel: 383 38 312 309 email: oshp@rks-gov.net

OSHP: 2023/0096
Data e Vendimit: 24.02.2023

Në bazë të nenit 105 pika 1 dhe 2, neni 108/A paragrafi 3 pika 1 të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, si dhe nenit 60. 1 pika b) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurim Publik për parashtrim të kërkesave për rishqyrtim, si dhe nenin 17 paragrafi 3 të Rregullores së Punës së OSHP-së nr. 01/2020, me numër të protokollit 83/2020 e amendamentuar me datën 30.09.2022, pas shqyrtimit të ankesës së OE GRANITI SH.P.K., kundër Vendimit për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit lidhur me aktivitetin e prokurimit “Blerja e mobiljeve dhe paisjeve për shkolla dhe qerdhe - per vitin 2021-2022” me numër të prokurimit 624-21-6928-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË, Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Vjosa Gradinaj me datën: 24/02/2023, mori këtë:

Vendim

Hedhet si e jashtafatshme, ankesa e GRANITI SH.P.K. me nr. të protokollit 2023/0096, e datës 18/02/2023, ankesë kjo e parashtruar për aktivitetin e prokurimit “Blerja e mobiljeve dhe paisjeve për shkolla dhe qerdhe - per vitin 2021-2022”, me numër të prokurimit 624-21-6928-1-2-1, inicuar nga autoriteti kontraktues (AK) – KOMUNA SUHAREKË.

I lejohet, autoritetit kontraktues – KOMUNA SUHAREKË që të vazhdojë më tutje me aktivitetin e prokurimit “Blerja e mobiljeve dhe paisjeve për shkolla dhe qerdhe - per vitin 2021-2022”, me numër të prokurimit 624-21-6928-1-2-1, përkitazi me këtë ankesë, nëse nuk ka ndonjë ankesë tjetër për këtë aktivitet të prokurimit.

Në përputhje me nenin 31 pika 4, të Rregullores së Punës së OSHP-së, operatorit ekonomik ankues i kthehet tarifa e ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës. OE ankues obligohet që konform nenit 31 pika 6 të Rregullores së Punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën i bëhet konfiskimi i depozitës, dhe këto mjete kalojnë Buxhetin e Republikës së Kosovës.

Arsyetim

Me datën 12.01.2023, Autoriteti kontraktues Komuna Suharekë, ka publikuar raportin e rivlerësimit për aktivitetin e prokurimit “Blerja e mobiljeve dhe paisjeve për shkolla dhe çerdhe - për vitin 2021-2022”, me numër të prokurimit 624-21-6928-1-2-1.

Me datën 02. 02. 2023, AK ka publikuar Njoftimin për dhënie B58. I pakënaqur me vendimin e AK-së, OE “Graniti” shpk si palë e interesuar në këtë procedurë të prokurimit, me datën 07. 02. 2023 në ora 16:06 minuta ka parashtruar kërkesë për rishqyrtim në AK.

Të njëjtit me datën 09. 02. 2023 me vendim kanë refuzuar kërkesën për rishqyrtim të OE të lartcitur.

OSHP pas shqyrtimit dhe analizimit të të gjithë dokumentacionit të lëndës, konstaton se kërkesa për rishqyrtim në autoritet kontraktues është parashtruar jashtë afatit ligjor të paraparë me nenin 108/A të LPP-së dhe nenin 60 pika b) të Udhëzuesit A001/2022 për Prokurim Publik, ku thuhet:

60.1 Kërkesa për rishqyrtim duhet të përmbajë të dhënat në pajtim me formularin F02 dhe duhet të dorëzohet tek autoriteti përkatës kontraktues nëpërmjet sistemit të prokurimit elektronik, funksioni “kërkesat për rishqyrtim” brenda afateve të mëposhtme:

b) Kurdo që kërkesa për rishqyrtim ka të bëjë me vendimin për dhënie të një kontratë ose të një konkursi të projektimit brenda afatit prej pesë (5) ditëve pas datës së publikimit të njoftimit mbi vendimin e AK (B58) ose njoftimit mbi rezultatet e konkursit të projektimit në sistem të prokurimit elektronik. Në kalkulim të afateve kohore, dita e publikimit të Njoftimit mbi vendimit të AK (B58) është dita (0).

Operatori ekonomik ka dorëzuar kërkesën për rishqyrtim në ditën e pestë (5), gjashtë minuta pas orës 16:00, andaj duke pasur parasysh sqarimet e dhëna si më lartë, OSHP konsideron se ankesa e dorëzuar nga OE “Graniti” është e jashtëafatshme dhe e njëjta nuk mund të shqyrtohet.

Vendimi për pikë e 3 të dispozitivit u morë në harmoni me nenin 31 pika 4 i Rregullores së Punës së OSHP-së.

Nga të lartcekurat, Kryetarja e OSHP-së, konform nenit 105 lidhur me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.



Këshillë juridike:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale - Departamentit për çështje Administrative për anulim vendimi në afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit.

Ky vendim është nxjerrë nga anëtarja e bordit znj. Kimete Gashi e cila ishte e autorizuar në mungesë të Kryetares.

Vendimi t'i dorëzohet:

- **AK - KOMUNA SUHAREKË**
- **OE - GRANITI SH.P.K.**
- Arkivës së OSHP-së: